

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

“ C.C.C. ” Shpk

(Cami Construction & Consulting)

Sot, me date 7.02.2024, une i nënshkruari, **Hysni Cami**, i lindur ne Shupenze Diber me date 14.07.1969 dhe banuese ne Tirane, shtetësisë dhe kombësisë shqiptare, pajisur me letërnjoftimin me nr. personal G90714146N ne baze te rregullimeve te Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, dhe Ligjit 9723 date 03.05.2007 “Për Qendren Kombetare te rregjistrimit”, i ndryshuar vendos të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi te Kufizuar te emëruar “ C.C.C.” Shpk (me poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjese përbërëse e këtij Akti Themelimi

Neni 1

FORMIMI I SHOQERISE

Formohet shoqëria e re me pergjegjesi te kufizuar, me emrin

“ C.C.C. ” Shpk

me ortake themelues z.Hysni Cami, i lindur ne Shupenze Diber me date 14.07.1969 dhe banuese ne Tirane, shtetësinë dhe kombësinë shqiptare, i pajisur me letërnjoftimin nr. personal G90714146N;

Neni 2

SELIA E SHOQËRISË

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga ” Vorpsi ”, Nd.4 Hyrja 1 , Ap23 , KP1044 ZK 3292 , Njësia administrative nr.13 Tirane

Me vendim te Asamblese se Ortakeve, selia e shoqerise mund te transferohet ne nje rajon tjeter brenda territorit te Republikes se Shqiperise. Gjithashtu, shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise apo dhe jashte territorit te saj.

Neni 3

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kohëzgjatja e veprimtarisë se Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon qe prej datës se regjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Bisnesit.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SE SHOQËRISË

1) Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

a- Veprimtari ne fushen e ndertimit projektim dhe zbatim, te sherbimeve konsultative per studime e planifikime urbane, arkitekturale e inxhinerike per objektet shumekateshe civile, social kulturore, rruge, ndertime hidroteknike, miniera e godina te rendesise se vecante si telekomunikacionit, rrjetit rrugor, hekurudhor e ne transport, aeroporte, porte, godina ushtarake, rrjetit te ujrave, energjise dhe rrjetit shperndares, spitalerite, godina te industrise, hotelerise, strehimit, bankave, pularive, stacioneve per prodhim mish, agrokultures, etj

b- Pergaditje projektesh per infrastrukturen, banesash shumekateshe, veprash sociale, hidroteknike, shkollore, turistike, energjitike, bujqesore, si dhe menaxhimi i tyre.

c- Grumbullim, transportim dhe ruajtje/magazinim i mbetjeve urbane, ambalazheve, inerte, dherave dhe llumrave të ujrave të zeza, menaxhimi i integruar i mbetjeve jo të rrezikshme.

d- Tregtim materiale te ndryshme ndertimi, inerte, mermer, elektrike, hidraulike, elektrike, fasadave, si dhe te gjithe materialete e tjera qe perdoren ne ndertim, makineri e pjese kembimi per llojet e ndryshme te makinerive.

e- Prodhim materiale ndertimi

f- Prodhim dhe montim grila, vetrata, fasada te objekteve, dyerve, kangjellave etj.

g- Supervizion dhe kolaudim te punimeve te larte permendura

h- Importi, eksporti, tregtia me shumicë dhe pakicë e mallrave, sipërmarrje dhe shërbimi në fusha të ndryshme, kryerja e veprimtarive dhe/ose pjesmarrja në çdo veprim ose aktivitet në perputhje me ligjet, në fushën e ndërtimit e te tregëtimit dhe çdo veprimtari në lidhje me to si dhe çdo aktivitet ekonomik që do të konsiderohet i nevojshëm dhe i dobishëm në mënyrë që të përmbushet qëllimi i veprimtarisë dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar

i- Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në menyre që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, shoqëria mund të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe çdo aktivitet tregtar, financiare, dhënie-marrje me qira, të vendos pengje dhe barrë hipotekore, aktivitete keto të konsideruara të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në mase aktivitetet kryesore, të cituara më sipër..

j- Transport mallrash brenda dhe jashte vendit.

k- Mirembajtje dhe menaxhim dhe administrim i objekteve civile, turistike. rrugore, hidroteknike, dhe te rendesise se vecante si dhe rikostruksioni i ketyre godinave etj.

l- Projektim, zbatim, mirembajtje periodike, riparim dhe rehabilitim ne fushen e automatizimit industrial ne makineri, mjete, pajisje, sisteme te ndryshme elektrike, elektronike, mekanike si: Sisteme, impiante, linja te trajtimit te mbetjeve; sistemime HVAC,MNZ etj.

m- Analize dhe vleresim te biznesit, i strukturave operative financiare per industri te ndryshme financimeve te ndryshme, modelim i biznesit, keshillime mbi ristrukturimin e organizimin financiar, studime tregu, plan biznesi, transaksionet dhe strategjine e shitjeve, keshillime mbi partnershipe te ndyshme, negocime te termave te marreveshjes, vleresime risku dhe keshillime per mitigimin e tyre

n- Studime fizibiliteti Sherbime ligjore;studime mjedisore sociol ekonomike; inxhinierike

o- Studime ne fushen e arkeologjise, dhe te trashegimise kulturore

p- Studime ne fushen e pyjeve dhe kullotave, hartimi i planeve te menaxhimit, inventarizim, sherbime plotesuese dhe aktivitete te tjera qe lidhen me pylltarine

q- Ushtrimin e profesionit te vleresimit te pasurive te lujtshme dhe te pa lujtshme

r- Studim -projektim dhe zbatim te projekteve fotovoltaike, eolike si dhe te hidrocentraleve.

s- Studim -projektim dhe zbatim te Eficenses se energjise ne ndertesa, impiante dhe ne industri.

2) Shoqëria mund të ushtrojë çdo veprimtari tjetër tregëtare dhe prodhuese e cila nuk ndalohet me ligj (Neni 7 i Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", i ndryshuar).

Neni 5 **Kapitali i shoqërisë**

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100000 Leke (njqind mijë mijë) Lek

Fondet e derdhura, lista e ortakëve me të dhënat e tyre personale dhe vlera e kontributeve përkatëse të ortakëve do të depozitohen në Bankë për llogari të shoqërisë në formim e sipër.

Kapitali i shoqërisë prej 100000 leke është nënshkruar plotësisht, dhe zotërohet tërësisht nga ortakët e shoqërisë:

Neni 6 **Organet e Shoqërisë**

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga organet e saj janë si më poshtë:

1. Asambleja e Ortakëve
2. Administratori.

Administratori i shoqërisë është z.Hysni Cami, i lindur në Shupenzë Diber më 14.07.1969 dhe banues në Tiranë, i shtetësisë dhe kombësisë shqiptare i paisur me kartë identiteti nr. personal G90714146N.

Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve dhe të Administratorit janë të përcaktuara në Statutin e shoqërisë.

Neni 7

Ortakët dhe punonjësit e shoqërisë janë të detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre qoftë dhe pjesërisht.

Neni 8 **Marrëdhëniet e punës**

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislativës së punës në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për demet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 9
Konfidencialiteti, ruajtja e sekretit

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike përmbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe janë përcaktuar si te tilla nga administratoret e kësaj shoqërie.

Neni 10

Ne se shoqëria do te likuidohet atëherë do te caktohet një komision likuidimi qe do te parashtroje një bilanc likuidimi për miratim.

Neni 11
Ekspertet ose revizoret kontabël

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet nje eksperti kontabël. Ky ekspert do te qëndrojë ne detyre per aq sa përcaktohet me ligj dhe mund te rrizgjidhet. Asambleja e Ortakut te vetëm cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma te veçanta ligjore.

Neni 12
Bilanci dhe Fitimet

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do te mbyllet ne dt. *31 Dhjetor te çdo viti*. Administratori merr masa për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi veçohen fondet si me sipër dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse ligjore.

Neni 13

Çdo mosmarrëveshje qe lind ndërmjet ortakut ne lidhje me ketë marrëveshje apo Shoqërinë (përveç atyre personale apo qe nuk kane te bëjnë me Shoqërinë), do te zgjidhet me mirëkuptim dhe do te diskutohet ne mënyre te drejtpërdrejtë ndërmjet palëve te interesuara.

Ne rast se nuk arrihet ne një zgjidhje me mirëkuptim te mosmarrëveshjes, çështja do t'i kaloje për gjykim Gjykatës se Shkalles se Pare Tirane.

Neni 14

Ky akt themelimi, si konfirmim i vullnetit te ortakeve themelues, nënshkruhet rregullisht

prej tyre ne Tirane, sot me 7.02.2024

ORTAKET THEMELUES TE SHOQËRISË “” Shpk

1. z.Hysni Cami